

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ISH MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJITIKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për koncesionet, për periudhën 01.10.2011 deri 31.12.2012, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr.8, datë 10.02.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshime, me shkresën nr.478/25, datë 14.02.2014 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z.Damian Gjijnuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e procedurave të konkurimit e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues të koncesionit, është konstatuar se Autoriteti Kontraktor, në Dokumentat Standarde të Procedurës Konkurruese, nga hyrja në fuqi e ligjit për koncesionet deri në muajin maj 2010 nuk ka vendosur tarifën që përfaqëson “vlerën në para”, ndërsa pas kësaj periudhe ka vendosur tarifën që përfaqëson një minimum 0.5% të vlerës së investimit. Vendosija e kësaj tarife, nuk është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”, i ndryshuar, sepse:

a. Në procedurat e realizuara në periudhën janar 2007 deri në maj 2010 nuk është vendosur tarifa që përfaqëson “vlerën në para”, që koncesionari fitues duhet të paguajë për Autoritetin Kontraktor para lidhjes së kontratës.

b. Ndryshimet e propozuara nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave, i ngarkuar për miratimin e procedurave për dhënien me koncesion dhe të dokumenteve standarde të procedurës së koncesionit, pasi në nenin 5, pika 4 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”, i ndryshuar, përcaktohet: “Këshilli i Ministrave miraton rregullat e vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve, si dhe dokumentet standarde në fushën e koncesioneve”.

c. Është vendosur një tarifë unike për vlerën në para, në masën 0.5% të vlerës së investimit, e pa argumentuar pse duhet të jetë në këtë masë dhe pse e njëjtë për koncesionet me parametra energjetik e vlera investimi të ndryshme. ***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, duke ju referuar neneve 48 dhe 50 të ligjit nr.125/2013, datë 24.05.2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, si dhe bazuar në nenin 29 të tij, të përcaktojnë nivelin e pagesës së “vlerës në para” në procedurat e konkurimit dhe të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, bazuar në parametrat energjitikë të veprave dhe e diferencuar sipas nivelit të këtyre parametrave. Të shikohet mundësia e vendosjes së kësaj tarife edhe për kontratat e koncesioneve të lidhura para vitit 2010, që do të jetë objekt i rishikimeve për shkak të mosplotësimit të detyrimeve kontraktore për realizimin e këtyre veprave energjitike brenda afateve kohore.

2. Nga auditimi është konstatuar se kushtet e parashikuara në Kontratat Koncesionare, për kërkesa apo probleme të së njëjtës natyrë janë të ndryshme, duke i vënë koncesionarët në pozita të pabarabarta edhe pse procedurat e përzgjedhjes mbështeten në të njëjtën bazë ligjore. Konstatohet se në hartimin e disa kontratave nuk janë pasqyruar mendimet e Avokatit të Shtetit, duke mos parashikuar afatin e paraqitjes së projektzbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktor, mungesë të Fee Koncesionare, të penalteteve për mosrespektimin e afateve, nivel i ndryshëm penalteti për shkelje të njëjta të kushteve të kontratës, apo në raste të veçanta kemi penaltete të Autoritetit Kontraktor për aspekte procedurale. Këto mangësi të kontratave krijojnë mundësinë që të mos vihen para përgjegjësisë e të penalizohen në rastet e mosrespektimit të kushteve të projektimit, realizimit dhe përfundimit të koncesionit në parametrat e projektuar, duke i favorizuar ato krahasuar me interesat e shtetit që mbeten të pa mbrojtura dhe siç ka rezultuar, të rrezikuara nga papërgjegjshmëria e këtyre operatorëve ekonomikë. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Duke shfrytëzuar hapësirat e nenit 28 të Kontratës, që lejon ndryshime, shtesa dhe/ose zevëndësime, me marrëveshje me shkrim nga palët, të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës ligjore e teknike, duke evidentuar problemet e natyrës së mësipërme në Kontratat e nënshkruara, dhe duke bërë rekomandimet konkrete për përmirësimet e mundshme ligjore, me qëllimin që koncesionarët në fushën e ndërtimit e shfrytëzimit të hidrocentraleve të vihen në pozita të barabarta, gjithmonë duke vepruar në mbrojtje të interesave të shtetit.

-Ministria e Energjisë dhe Industrisë të punojë mbi bazë të kontratave tip (sipas niveleve të parametrave energjitikë) të hartuara në bashkëpunim me Avokatin e Shtetit, duke siguruar në këtë rast që të trajtohen të gjithë koncesionarët njësoj, por dhe të mbrohen interesat e shtetit.

3. Nga auditimi i kryer në monitorimin e kontratave koncesionare janë konstatuar raste të transferimit të aksioneve deri në masën 100% (edhe menjëherë pas lidhjes së kontratës koncesionare), duke ruajtur vetëm emrin e shoqërisë koncesionare të krijuar mbas lidhjes së kontratës koncesionare me fituesin dhe duke i lënë formalisht të drejtat e detyrimet kësaj të fundit, në çënim të plotësimit të shtimit të marrëdhënieve kontraktuale dypalëshe. Raste të tilla kompromentojnë marrëveshjet koncesionare dhe marrëdhëniet me shtetin lidhur me përgjegjësitë e koncesionarit gjatë gjithë kohës së koncesionit. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të realizohen ndërhyrjet e duhura në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të ndërmerren iniciativa për hartimin e një udhëzimi të veçantë, lidhur me procedurën e transferimit dhe masën e aksioneve, *për të cilën gjykojmë se nuk duhet të kalojë 49% të tyre* (pra koncesionari i përcaktuar fitues në garë të jetë zotërues i paketës kontrolluese), dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti, si dhe procedurën e vlerësimit të dokumentave të paraqitura dhe kapaciteteve ekonomiko-financiare e tekniko-juridike.

4. Nga auditimi është konstatuar se për arkëtimin e penalteteve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor ndaj koncesionarëve për shkelje të kushteve, gjatë zbatimit të kontratave, janë njoftuar koncesionarët dhe Shoqëritë e Sigurimeve, të cilat janë garantuese të plotësimit të kontratës, kjo e sanksionuar në formularin e sigurimit të kontratës (Aneksi C i DSPK) i cili është në formën e Garancisë Bankare apo Policë Sigurimi, ku përcaktohet se: *“Deklarojmë se jemi garantuesit e sipërpërmendur deri në shumën totale prej..., shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë. Ne marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni*

kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë brenda kufirit prej(shuma e garancisë). Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është e nevojshme ti drejtoheni më parë Koncesionarit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj...”

Pavarësisht nga njoftimet e Autoritetit Kontraktor ndaj Shoqërive të Sigurimeve për arkëtimin e detyrimeve, që deri në përfundim të auditimit arrijnë në shumën **387 milion lekë (afërsisht 3.90 milion USD)**si dhe kërkesave ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të ndërhyrë dhe detyrimin e shoqërive siguruese të përmbushin detyrimet e tyre, është bërë i pamundur arkëtimi nga Autoriteti Kontraktor i konfiskimit të vlerave të sigurimit të kontratës, kryesisht atyre të siguruara në kompanitë e sigurimit, duke u bërë pengesë në zbatimin e DSPK dhe akteve nënligjore.

Nisur nga konstatimet e auditimit, por edhe nga fakti se në ligjin nr.125/2013, datë 25.04.2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, neni 20 “Dokumentete e tenderit”, ku përcaktohet se dokumentat e tenderit hartohen dhe trajtohen nga autoriteti kontraktues në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për të siguruar garantimin e arkëtimin të vlerës së sigurimit të kontratave, si dhe për të evituar zgjatjen e konflikteve që mund të rezultojnë në sigurimin pranë kompanive të sigurimit kërkojmë të bëhet përmirësim ligjor në DSPK si dhe në aktet nënligjore. ***Për këtë është rekomanduar:***

a. Të kërket nga Këshilli i Ministrave, ***ndryshimi*** i pikës 2/ë, kreu III, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, ***që sigurimi i kontratës të bëhet vetëm pranë bankave***, duke hequr të drejtën e sigurimit pranë kompanive të sigurimit, për të mundësuar arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga mospërmbushja e kushteve kontraktore nga koncesionarët.

b. Të kërket nga Agjencia e Prokurimit Publik, të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për vendosjen e sanksioneve të forta për shoqëritë e sigurimeve në rastin e mospërmbushjes së detyrimit të tyre për konfiskimin e sigurimit të kontratës për llogari të Autoriteteve Kontraktore, në nga kontraktuesit për realizimin e kontratës, duke e konsideruar këtë veprim kundravajtje administrative, kjo për sa kohë do të zgjasë periudha e miratimit të kërkesës (a).

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i dokumentacionit për monitorimin e zbatimit të kontratave koncesionare në ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore janë vërejtur problematika dhe konflikte të shoqërive koncesionare kryesisht për kuotat e veprave energjitike. Është konstatuar se, Grupi i Oponencës Teknike Shtetërore dhe Grupi i Identifikimi të Projekteve Propozimeve (GIPP) në METE, në disa raste, përpara realizimit të procedurave konkurruese, nuk kanë vlerësuar me korrektësi të gjitha detajet mbi analizën e rentabilitetit, fizibilitetit dhe të përshtatshmërisë teknike të projekteve të paraqitur, duke sjellë edhe konfliktet midis operatorëve ekonomikë. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me strukturat e saj të varësisë të rishikohet Strategjia Kombëtare, në mënyrë që t’i jepet zgjidhje problemeve të shfrytëzimit të kapaciteteve ujore, përdorimit të tyre pa përkeqësuar jetën dhe aktivitetin e përditshëm të qytetarëve dhe në respekt të aspekteve mjedisore dhe marrvëshjeve rajonale të shfrytëzimit të ujrave, kërkesë kjo edhe e ligjit nr.125/2013, datë 25.04.2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” neni 8, pika 5.

Strategjia të reflektojë edhe ndjekjen e monitorimin e këtyre koncesioneve, për të patur një panoramë të plotë të veprave energjitike të dhëna me koncesion dhe ecurinë e tyre, në mënyrë që realizimi i çdo procedure konkurruese për të marrë me koncesion burimet ujore kombëtare për përfitim të energjisë elektrike dhe përmirësimin e furnizimit të sistemit hidro-energjetik shqiptar, i propozuar nga subjektet private në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mos rezultojë një sipërmarrje e dështuar.

2. Nga auditimi i procedurave konkurruese për dhënie me koncesion të Hece-ve, është konstatuar se mungon rregjistri i koncesioneve, i cili nuk është hartuar nga Autoriteti Kontraktor, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar dhe VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, Kreu VIII, pika 7. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të merren masa të menjëhershme për krijimin dhe plotësimin e rregjistrit të koncesioneve, si dhe të një *database* ku të pasqyroheshim të dhënat për të gjitha koncesionet e dhëna, kjo në mbështetje të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar dhe VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar.

-Ky rregjistër të jetë i disponueshëm për të gjithë të interesuarit, në kuadër të transparencës së nevojshme për të siguruar mirëadministrim të këtyre koncesioneve.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, ***të analizojë dhe të vendosë për vazhdimësinë*** e mëtejshme të kontratave koncesionare, *që janë në kushtet e shkeljeve serioze të marrëveshjeve koncesionare, duke mos zbatuar detyrimet kontraktore, si dhe duke e bërë të pamundur realizimin e veprave energjitike në kohë, në kundërshtim të plotë me ligjin nr.9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar dhe VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, por duke patur parasysh që vendimi të mos ketë kosto për shtetin dhe të synojë vënien në efikasitet të këtyre projekteve.*

4. Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes, mbas lidhjes së kontratës koncesionare, është konstatuar në shumë raste, miratimi i ndryshimeve të projekt-zbatimeve, arësytuar me qëllimin e mirë për optimizimin e veprave hidro-energjitike, përmirësimin e treguesve energjetik dhe hidroteknik. Në të gjitha rastet e trajtuara në materialin e auditimit, megjithë rekomandimet e vazhdueshme të grupit të Oponencës Teknike Shtetërore, që këto ndryshime të pasqyrohen në Kontratën e Koncesionit, Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar. ***Për këtë është rekomanduar:***

a. Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për të gjitha rastet e ndryshimit në rritje të parametrave hidro-energjetik, si fuqinë e instaluar, prodhimin vjetor të energjisë elektrike, apo vlerën e investimit, të kërkojë pasyrorimin e ndryshimeve në Kontrata Shtesë të nënshkruara nga palët.

b. Meqenëse treguesit e rinj hidro-energjetik, pranohen nga palët nëpërmjet miratimit të dokumenteve të tillë si projekt-zbatimet të ndryshuar, oponenca teknike që bëhet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, etj, me ndërtimin e veprës hidro-energjetike, të bazohet në

treguesit përfundimtarë, pra edhe testimi i veprës të bëhet mbi bazën e treguesve të përmirësuar hidro-energjetik.

5. Nga auditimi i Kontratave Koncesionare për ndërtimin e HEC-eve, është konstatuar se me miratimin e projekt-zbatimit të ndryshuar, është ulur prodhimi vjetor i energjisë elektrike, kjo është në kundërshtim me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve” i ndryshuar dhe me procedurat e konkurrimit e të shpalljes së fituesit. ***Për këtë është rekomanduar:***

Mbështetur në nenin 28 të Kontratës Koncesionare, të bëhen ndërhyrjet e nevojshme në kontrata, ku të cilësohet që, parashikimi i prodhimit vjetor të energjisë elektrike, të mos bjerë nën nivelin e shpallur fitues.

Gjithashtu, nga Autoriteti Kontraktor në të ardhmen të mos pranohen ulje të treguesve të parashikuara në kontratë dhe dokumentat e garës, pasi në këtë rast kemi prishje të kriterëve mbi të cilat koncesionari është shpallur fitues.

6. Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e afateve nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për kryerjen oponentes teknike të projekt-zbatimit të paraqitur nga shoqëritë koncesionare mbas lidhjes së kontratave, rezulton se ka vonesa jo vetëm nga koncesionarët (për të cilat llogariten penalitete për koncesionarin), por dhe nga Autoriteti Kontraktor e vetë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Vonesat vijnë për shkak të kapaciteteve njerëzore që ka Agjencia për të përballuar volumin e punës për shqyrtimin e vlerësimit e një numri të madh të projekteve të zbatimit, por edhe nga qëndrimet jokorrekte të koncesionarëve për t’ju përgjigjur në kohë sa më të shpejtë kërkesave të Oponentes Teknike në rastet e mangësive dhe parregullsive dokumentare, apo mospagesës në kohë të tarifës për kryerjen e oponentes, etj. Një gjendje e tillë ka qenë shkak për fillimin me vonesë të punimeve në objektet koncesionare dhe në ndërtimin e Hec-eve sipas afateve të parashikuara në kontrata. ***Për këtë është rekomanduar:***

a. Të përcaktohen qartësisht përgjegjësitë e gjithsecilit në këtë proces, në rastet e vonesave në dërgimin dhe kryerjen e oponentes së projekt-zbatimit.

b. Të bëhen përmirësimet apo plotësimet e nevojshme në Rregulloren e miratuar të funksionimit të Oponentes Teknike Shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ku të reflektohen problematikat e konstatuara. Të përcaktohen afate konkrete për kthimin e përgjigjeve apo paraqitjen e dokumentacionit të munguar nga koncesionarët, në rastet kur kërkohen plotësime apo rregullime të projekt-zbatimit, afate që do të garantonin një oponente cilësore dhe do të parandalonin formalitetin në këtë proces.

c. Të rregullohet funksionimi i Oponentes Teknike, që të mos bëhet pengesë numri i mbledhjeve të këtij organizmi, gjatë muajit.

7. Në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore është konstatuar mungesë rakordimi të veprimeve me Autoritetin Kontraktor për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave. Veçanërisht mbi dokumentacionin ekonomik-financiar që duhet të paraqesin koncesionarët për zbatimin e kontratës në faza të ndryshme të ndërtimit (bilance, fatura, etj), të cilat mungojnë pothuajse për çdo kontratë koncesionare. Një shkak për gjendjen e krijuar në

fushën e dokumentacionit për monitorimin është nënshkrimi i kontratave ndërmjet ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe koncesionarëve, pa përfshirë Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si institucioni monitorues. Rrjedhimisht të drejtat e detyrimit janë drejtpërdrejtë me Autoritetin Kontraktor dhe jo me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, e cila bën monitorimin e zbatimit të këtyre kontratave. ***Për këtë është rekomanduar:***

a. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në mënyrë urgjente duhet të përgatisin një bazë rregullatore që do të qartësojë mënyrën e organizimit, funksionimin, bashkëveprimin, dokumentacionin që duhet mbajtur në terren nga grupet e monitorimit të Kontratave Koncesionare, kjo duke saktësuar në çdo rast përgjegjësinë e gjithsecilit dhe sanksionet për anashkalim të këtyre përgjegjësisë.

b. Të përcaktohet qartë detyrimi dhe përgjegjësia ligjore e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, duke bërë dhe plotësime të nevojshme ligjore për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave, duke vënë theksin në dokumentimin e investimeve dhe vlerësimin tekniko-ekonomik të koncesionit në fund, si i vetmi organ i specializuar dhe me burime njerëzore të mjaftueshme.

8. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e Koncesioneve për ndërtimin e shfrytëzimin e HEC-eve, është konstatuar se, koncesionarët nuk paraqesin informacion mbi realizimin e investimeve në vlerë, mungojnë situacionet për punimet e realizuara, faturat tatimore e doganore, nuk paraqiten bilancet e shoqërive koncesionare për aktivitetin vjetor etj. Mungojnë procesverbalet e fillimit të punimeve, procesverbalet e mbikëqyrësit për punimet e kryera, etj. Mungesa e dokumentacioni ka bërë të pamundur vlerësimin real të investimeve të kryera, duke sjellë edhe pamundësinë e llogaritjes së penalteteve nga Autoriteti Kontraktor. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të bëjnë rakordimin me koncesionarët, plotësimin me dokumentacionin ligjor, teknik dhe financiar që ka dhe duhet të përmbajë dosja e koncesionit dhe sipas konstatimeve të bëjë dhe përlllogaritjen e penalteteve.

-Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të mundësuar lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre mbi dokumentacionin financiar të dorëzuar nga koncesionarët.

9. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për arkëtimin e garancisë së kontratës në formën e depozitës bankare në ***shumën 4 milion Euro***, si detyrim kontraktor nga shoqëria koncesionare [REDAKTUAR], e cila rezulton e pa depozituar, në kundërshtim me nenin 15.3 të kontratës së koncesionit e formës “BOT”, lidhur midis METE-s dhe shoqërisë koncesionare [REDAKTUAR], për ndërtimin e hidrocentralit të “Kalivaçit”, miratuar dhe ndryshuar me disa shtesa VKM nr. 222, datë 24.05.1997, botuar në Fletoren zyrtare extra nr. 19 të Qershorit 2005, ndryshuar me VKM nr. 590, datë 02.11.2000, botuar në Fletoren zyrtare nr. 36, datë 15.11.2000 dhe VKM nr. 363, datë 06.06.2007, i pa botuar në Fletoren zyrtare.

10. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë të gjitha masat, që nga ana e shoqërisë koncesionare [REDAKTUAR], ***të plotësohet kapitali minimal prej 15 milion***

Euro, kjo në zbatim të nenit 13 të marrëveshjes koncesionare të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Koncesionari merr përsipër që brenda 180 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj shtesë, koncesioni të zotërohet nga një shoqëri e kontrolluar nga [REDAKTUAR] dhe me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë ose jo të [REDAKTUAR] me një pjesë në kapital prej 45 % të kapitalit aksioner. Kjo shoqëri do të ketë një kapital fillestar minimal prej 15.000.000 Euro.

11. Në auditimin për zbatimin e kushteve të Kontratave Koncesionare, u konstatua se, nuk është punuar për rilogaritjen e tarifës që Koncesionarët fitues paguajnë për Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve në zbatim të VKM nr.191, datë 22.03.2012, (ndryshim i VKM nr. 150, datë 22.03.2007), për arkëtimin e saj në buxhetin e shtetit. Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e vitit 2012, ***ka llogaritur mungesë të ardhurash në vlerën 1,113,730,319 lekë (afërsisht 11,137,303 USD)***, detyrim që duhet paguar nga Koncesionarët e shpallur fitues. Nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve është punuar për vjeljen e tarifës për periudhën nga dalja e VKM nr.191, datë 22.03.2012 e vazhdim, por jo që nga data 22.03.2009, periudhë që ka shtrirë efektet vendimi. ***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në bashkëpunim me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, të bëjë rilogaritjen e vlerës tarifës, që koncesionarët duhet të paguajnë me ndryshimet e bëra me VKM nr.191, datë 22.03.2012, ***të bëjë kontabilizimin dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të vitit 2013 të detyrimeve për këtë tarifë (të analizuar sipas viteve 2012-2013).***

12. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezultoi se: Për shpërblimin e dëmit ekonomik prej **595,146,011 lekë** nga 24 shoqëri koncesionare, për mos pagim të detyrimeve ligjore sipas kushteve të kontratës së lidhur midis palëve, është arkëtuar detyrimi nga 3 shoqëri në shumën **207.949.656 lekë**. Konstatohet se këto detyrime nuk janë kontabilizuar dhe paraqitur në evidencën kontabile të institucionit, por mbahen thjesht si evidenca nga Drejtoria e Monitorimit të Kontratave. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të kryhen kontabilizimet e detyrimeve për 24 shoqëri koncesionare, sipas Raportit të Auditimit të KLSH-së të vitit 2012, të evidentohet e ardhura e përfituar nga shpërblimi i dëmit në masën 207,949,656 lekë për vitin 2013, si dhe të jepen shpjegime të plota për këto transaksione në pasqyrat financiare të vitit 2013. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e dëmit në buxhetin e institucionit.

13. Nga auditimi i Kontratës Koncesionare për dhënien me koncesion të ish Uzinës së Rafinimit të Bakrit, Rubik, nënshkruar me datë 17.12.2012 nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe koncesionari shoqëria [REDAKTUAR], u konstatua se:

Në kundërshtim me VKM nr.297, datë 02.05.2012 dhe Dokumentat Standarte të Procedurës së Koncesioneve ku është përcaktuar forma e koncesionit BOT (Ndërtim-Shfrytëzim-Transferim), kontrata e nënshkruar është e formës “ROT”(Rehabilitim-Shfrytëzim-Transferim), pra në mënyrë të paargumentuar, Autoriteti Kontraktor ka ndryshuar formën e miratuar të koncesionit nga Këshilli i Ministrave.

Nga auditimi i kësaj kontrate rezulton se nuk plotëson kërkesat e Dokumentave Standarde të Procedurës së Koncesioneve dhe të VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, e konkretisht:

- mungon përshkrimi i sigurimit të kontratës;
- nuk është vendosur fee koncesionare;
- nuk është vendosur vlera e riinvestimit të objektit pas 25 vjetësh në masën 60 % të vlerës së investimit;
- nuk përcaktohen kufizimet për shitjen e aksioneve;
- nuk përcaktohen kufizimet për nënkontraktimet.

Për këtë është rekomanduar:

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Avokturën e Shtetit, mbështetur në nenin 17 të Kontratës Koncesionare, të bëhen amendimet e duhura nëpërmjet lidhjes së kontratës shtesë, për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit dhe vënien në efikasitet të këtij koncesioni nëpërmjet detyrimit të koncesionarit për të plotësuar detyrimet kontraktore.

14. Nga auditimi është konstatuar se, në fushën e dhënies më koncesion të Ish Uzinës së Telave e Kablove në Shkodër, sipas Marrëveshjes Koncesionare ndërmjet Organit Shtetëror të Autorizuar (ish Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe firmës [REDAKTUAR] nuk janë zbatuar kushtet e marrëveshjes. Investimet janë realizuar në masën 1 milion USD nga 10 milion USD të parshikuara, nuk është bërë sigurimi i objekteve, nuk janë mbajtur në punë punëtorët e ish Uzinës, prodhimi është realizuar në nivele shumë të ulëta (deri në 10%). etj. Megjithatë janë organizuar shumë kontrolle e vlerësime nga OSHA për realizimin e Marrëveshjes Koncesionare, gjendja është mjaft problematike. ***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të realizojë evadimin e materialit të kontrollit të filluar në fund të vitit 2012 dhe të ushtruar në fillim të vitit 2013 nga Grupi i Punës, të vërë në dijeni koncesionarin me problemet dhe të trajtuara nga OSHA, në mënyrë që të sigurohet marrja e menjëhershme e masave për të sjellë situatën në normalitet dhe vendosjen e koncesionarit në kushte të plotësimit të detyrimeve kontraktuale sipas një plani veprimesh të mirëdetajuar dhe të pranueshme nga të dyja palët.

15. Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë të bëhen përlllogaritjet e penaliteteve, kontabilizimi dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare të detyrimit, për ato koncesionarë që nuk kanë realizuar prodhimin vjetor, për hece-t e vënë në punë në periudhë më të vogël se sa një vit kalendarik, pasi në mungesë të dokumentacionit Grupi i Auditimit nuk mund të përcaktonte skemën optimale të shfrytëzimit.

Detyrimi i llogaritur të kontabilizohet dhe të paraqitet në pasqyrat financiare të vitit 2013. Analiza e këtij detyrimi, sipas periudhave dhe koncesioneve të shoqërojnë këto pasqyra financiare (shënimet shpjeguese).

Autoriteti Kontraktor të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve të llogaritura.

16. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për vitet 2011 dhe 2012 vetëm për një numër shumë të vogël të HEC-eve të futur në prodhim, është kryer testimi në prani të përfaqësuesve të

Autoritetit Kontraktor dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Prania e Autoritetit Kontraktor në testimin e veprave është e domosdoshme për të saktësuar respektimin e kushteve të kontratës të cilat janë të pandryshueshme si, fuqia e instaluar dhe prodhimi vjetor i energjisë, pa lënë mënjane kushtet e tjera që kanë të bëjnë me vlerën e investimit të realizuar, makineritë e pajisjet e vëna në punë, etj. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të ngrejë një grup pune me përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe KESH sha, për kryerjen e testimit të hidrocentraleve të vënë në shfrytëzim, por që nuk janë testuar në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor, kjo bazuar në një procedurë, dokumentacion e përgjegjësi të mirëpërcaktuara, dhe që do të jenë pjesë e bazës rregullative të këtyre lloj koncesioneve. Kjo do të formalizojë procedurat, por dhe do të ndërgjegjësojë palët për të drejtat dhe përgjegjësitë që mbart ky proces me shumë rëndësi.

17. Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, si Autoritet Kontraktor, KESH sha dhe koncesionarëve, të bëhet akt rakordimi i përbashkët ndërmjet palëve, për prodhimin e realizuar nga koncesionarët dhe të shitur KESH-it, si dhe detyrimet që rrjedhin sipas kushteve të kontratave, detyrim që duhet të jetë i dokumentuar, evidentuar në kontabilitet dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2013, në mënyrë që të ndiqet në vazhdimësi.

18. Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të kërkohej nga KESH sha, arkëtimi i shumës **48,045,049 lekë**, si detyrimi për fee koncesionare për prodhimin e realizuar dhe të shitur KESH sha, për vitet 2011-2012, e cila nuk është derdhur në buxhetin e shtetit.

Nga Autoriteti Kontraktor të llogaritet dhe evidentohet në kontabilitet detyrimi për vitin 2013. Pasqyrimi i këtij detyrimi në pasqyrat financiare të vitit 2013, të shoqërohet me shënime të plota shpjeguese për analizën e tij sipas viteve.

19. Nga auditimi i ushtruar ka rezultuar se në dosjet e koncesioneve në Ministri ka mangësi të dokumentacionit lidhur me procedurat e koncesionit që administrohet në këto dosje dhe të dokumentacionit të monitorimit të tyre. Grupi i Auditimit konstatoi dhe një rast flagrant, ku dosja e procedurës së dhënies me koncesion për hec “Bllicë”, rrethi Peshkopi nuk gjendej dhe administrohej nga arkivi i institucionit. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë të merren të gjitha masat për plotësimin e dokumentacionit në dosjet e koncesionit në ministri dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe arkivimin e administrimin e tyre sipas ligjit të arkivave.

20. Nisur nga ankesa që është depozituar në Kontrollin e Lartë të Shtetit nga koncesionari [REDAKTUAR], me shkresën nr.29/9, datë 28.02.2013 me objekt: “Kërkesë për ndërhyrjen e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku kërkon nga institucioni jonë zgjidhjen e problemit të krijuar për pajisjen e koncesionarit me licensën për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Gizavesh”, rrethi Librazhd, kjo në mbështetje të kontratës së koncesionit të formës “BOO”, të lidhur më datë 15.01.2005 ndërmjet koncesionarit dhe OSHA(Ministria e Industrisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit”), bazuar në VKM nr.300, datë 14.05.2004 dhe se nga auditimi i ushtruar në ish METE dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore rezultoi se ky

hydrocentral është vënë në punë, por me koncesionar tjetër. Nga auditimi u konstatua se, kjo kontratë nuk është monitoruar apo asistuar nga këto institucione. ***Për këtë është rekomanduar:*** Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të kryhet monitorimi i kontratës koncesionare të Hec “Gizavesh”, të evidentohen problematikat në zbatimin e kësaj kontrate, si dhe të angazhohet në zgjidhjen e tyre, kjo në mbështetje të nenit 5 “Detyrimet e OSHA” të marrëveshjes koncesionare, ku përcaktohet se: “Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër...të ndihmojë koncesionarin në finalizimin e një marrëveshje afatgjatë me KESH sha, për shitjen e energjisë elektrike, për aq sa kohë që KESH sha të jetë me kapital tërësisht shtetëror”.

21. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është depozituar një ankesë nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ■■■, me shkresën nr.67 datë 23.07.2013. me objekt: “ Informacion lidhur me disa shkelje të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë ish METE dhe Komisioni i Prokurimit Publik”, për procedurën konkurruese për ndërtimin e ***Hec “Denas”, rrethi Korçë.*** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për organizimin e procedurës konkurruese të përzgjedhjes, hartimit të Dokumentave Standarde të Procedurës Konkurruese, si dhe hapjes e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë koncesionare rezultoi se:

Në këtë procedurë KVO-ja ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtin kriter, ku në gjykimin tonë në bazë të auditimit nga pikëpamja ligjore këto oferta nga operatorët ekonomikë nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, duke skualifikuar në mënyrë jo të drejtë bashkimin e përkohshëm të shoqërive ■■■, për ndërtimin e Hec “Denas”.

*Kontrata koncesionare e formës BOT, për ndërtimin e Hec Denas, është lidhur midis METE-s dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive ■■■ me nr.62 rep & nr.10 kol datë 03.04.2013, pra jashtë periudhës së auditimit nga Grupi i Auditimit. ***Për këtë është rekomanduar:****

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të merren të gjitha masat për auditimin e plotë të procedurës dhe të negocimit të kontratës koncesionare të formës BOT e lidhur midis METE-s dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive ■■■ me nr.62 rep & nr.10 kol, datë 03.04.2013 për ndërtimin e Hec Denas, lidhur si pasojë e procedurës jo të drejtë konkurruese nga ana e KVO-së, e cila ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtin kriter, duke nxjerrë personat përgjegjës, si dhe njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit e bashkimin e operatorëve ekonomik ■■■ shpk mbi rezultatet e këtij auditimi.

22. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është depozituar një ankesë nga ■■■ me shkresën nr.65 datë 20.07.2013. me objekt: “Informacion lidhur me disa shkelje të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë ish METE”, për procedurën konkurruese për ndërtimin e ***Hec “Bllicë”, rrethi Peshkopi.*** Në ankesën e tij Operatori ekonomik ankimes shoqëria ■■■, pretendon se është skualifikuar pa të drejtë nga Autoriteti Kontraktues.

Meqenëse gjatë periudhës së auditimit edhe pas kërkesave të përsëritura të Grupit të Auditimit nuk na u vu në dispozicion procedura e dhënies me koncesion të këtij hec-i, e për rrjedhojë kjo praktikë nuk u arrit të auditohej, ***është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të merren të gjitha masat që të ngrihet një grup pune për auditimin e procedurës konkurruese për dhënien me koncesion për ndërtimin e Hec-“Bllicë”, duke evidentuar problematikat, duke nxjerrë personat

përgjegjës për administrimin e dosjes dhe mosvënien në dispozicion të Grupit të Auditimit dhe në përfundim njoftimin e operatorit ekonomik konkurrues shoqërisë ■■■ mbi rezultatet e këtij auditimi.

23. Në procedurën konkurruese për dhënien me koncension të Hec-eve në Kasadën e Lusës, nëpërmjet shfrytëzimit hidroenergjetik të përroit të Lusës, rrethi Burrel, KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, Kreu IX, neni 2, paragrafi f, dhe paragrafi c. ***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të merren masa për rishikimin e procedurës konkurruese dhe të kontratës koncesionare, duke nxjerrë dhe përgjegjësinë konkrete, kjo në zbatim të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar dhe VKM nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Mbështetur në nenin 608, të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të fillojnë procedurat ligjore për nxjerrjen e akteve administrative për shpërblim dëmi, të kryhen kontabilizimet dhe të arkëtohen detyrimet si më poshtë:

A. Nga auditimi u konstatuan raste të paraqitjes me vonesë të projekt-zbatimit të kontratave koncesionare, kjo për faj të koncesionarit, por nga Autoriteti Kontraktor nuk janë marrë masa ndaj koncesionarëve për zbatimin e këtij kushti të kontratës e penalizimin e tyre. Për mosrespektim të afateve janë përlllogaritur penalitete në masën 0.005% të vlerës së investimit për çdo ditë vonesë dhe kërkohet arkëtimi i shumës 84,904,880 lekë, nga 13 shoqëri koncesionare.

B. Nga auditimi mbi realizimin e investimeve të parashikuara në kontratat koncesionare u konstatua një nivel shumë i ulët i realizimit të tij për shumë nga koncesionet e dhëna. Për mosrealizim të investimeve në afatet e parashikuara sipas kontratave koncesionare, janë llogaritur penalitete në masën 10 % të vlerës së investimit të munguar, gjithsej në shumën 577,826,539 lekë, të cilat duhet të arkëtohen nga 10 shoqëri koncesionare.

C. Nga auditimi rezultoi se, Autoriteti Kontraktor për mosrealizim të prodhimit vjetor nuk ka penalizuar koncesionarët përkatës sipas kushteve të kontratës. Nisur nga ky fakt për mosrealizim të prodhimit vjetor, i parashikuar sipas kontratave koncesionare, janë llogaritur penalitete të cilat duhet të arkëtohen nga 8 shoqëri koncesionare, në shumën 38,980,406 lekë.

D. Nga auditimi është konstatuar se nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk janë përlllogaritur saktë, ose nuk është përlllogaritur e derdhur tarifa e Oponencës Teknike të projekt-zbatimit të kontratave koncesionare në fushën e energjisë, në kundërshtim me VKM nr.547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” i

ndryshuar, pika 3, VKM nr.444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimin dhe kolaudit të veprave të ndërtimit”, VKM nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhërit nr.893, datë 16.12.2010 të Ministrisë të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe Urdhërit të Brëndshëm nr.944, datë 20.12.2011.

I. Nuk janë bërë përlllogaritjet e vlerës së tarifës së oponencës teknike mbi projekt-zbatimin dhe arkëtimi i këtyre vlerave nga 3 shoqëri koncesionare, në shumën 717,824 lekë.

II. Nuk janë bërë përlllogaritjet e sakta të tarifës së oponencës teknike mbi projektzbatimin, duke rezultuar kështu diferenca krahasuar me arkëtimet e këtyre tarifave nga 6 shoqëri koncesionare në shumën 834,723 lekë.

E. Nga auditimi është konstatuar se nga Autoriteti Kontraktor nuk janë përlllogaritur, kontabilizuar dhe kërkuar detyrimet e koncesionarëve në fushën e bakrit, gjithsej në shumën 253,196,144 lekë për dy shoqëri koncesionare.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Në bazë të legjislacionit për shërbimin civil dhe mbështetur në nenin 26/1, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Konçesionet”, i ndryshuar, për personat të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i rekomandojmë Ministrinë të Energjisë dhe Industrisë të bëjë vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore nga: “vërejtje” deri në “largim nga shërbimi civil”, si dhe indicie për veprë penale në raport me shkeljet e konstatuara. Në përfundim, për këto masa të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

D.2. Të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për Ish Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë ■■■, i larguar nga puna, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, sipas legjislacionit për shërbimin civil, pasi:

Me veprimet dhe mosveprimet e tij ndikoi në zgjatjen e afatit në kryerjen e këtij auditimi, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit me përfaqësuesit e KLSH-së dhe bllokimit të procesit të auditimit, për një periudhë prej një muaj e gjysëm, situatë e cila u zhbllokua me ndërhyrjen e ish ministrit dhe deputetit z. ■■■.

D.3. Në bazë të nenit 37 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr.547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, në Rregulloren e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26 dhe “Rregulloren për funksionimin e grupit “Për kryerjen e Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN” e datës 18.10.2010, neni 7, pika 6, i rekomandojmë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, marrjen e masave disiplinore si më poshtë vijon:

-“Vërejtje me shkrim” për: ■■■, me detyrë N/Kryetar i Grupit të Oponencës Teknike, ■■■, me detyrë anëtare e Grupit të Oponencës Teknike dhe ■■■ me detyrë anëtare e Grupit të Oponencës Teknike, për moszbatimin e afateve kohore për marrjen e vendimeve të Oponencës

Teknike për projekt-zbatimin për ndërtimin e hidrocentralit “Labinot-Fushë” rrethi Elbasan; për ndërtimin e hidrocentralit “Orenjë” rrethi Librazhd dhe për ndërtimin e hidrocentraleve “Fterre dhe Fterre 1” rrethi Sarandë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selime BREGU p/grupi, Fadil DEKOVI, Monika DUSHKU, Valentina GOLEMI dhe Evis KRESHPAJ, më tej materiali u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal YZEIRAJ, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit znj.Manjola NAÇO dhe Sekretari i Përgjithshëm znj.Luljeta NANO.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT